

VENDIM
Nr. 166, datë 6.3.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR PËRZGJEDHJEN E NJË
SHOQËRIE PËR NDËRTIMIN E RRJETEVE NUMERIKE (DIGJITALE) TË OPERATORIT
PUBLIK (RTSH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e përzgjedhjes së shoqërisë implementuese të projektit për ndërtimin e rrjeteve numerike (digjitale) të operatorit publik (RTSH), të formës “FDNT” (financim, dizënjim, ndërtim dhe transferim) është Ministria për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit.

2. Ngarkohet Ministri për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Ministri i Financave, si dhe institucionet e tjera publike të përfshira, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha